



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:173997
Datë: 19.01.2024
Numri i dokumentit: 05214607

Ac.nr.9913/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, F.A nga Podujeva, rruga “H.” pn., të cilin e përfaqëson i autorizuari B.S, avokat nga Podujeva, Rruga “...” nr..., me autorizim, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nga Fushë Kosova, Zona Industriale, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë, Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensim dëmi material, vlera e kontestit 134,600.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.329/2011, i datës 05.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHËT POSHTË si e pasafatshme ankesa e paditësit F.A nga Podujeva, rruga “H.” pn., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.329/2011, i datës 05.10.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar, C.nr.329/2011, i datës 05.10.2021, ka vendosur si në vijim:

“REFUZOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit F.A nga Podujeva, Rruga “H.” pn., si e pabazuar, me të cilën ka kërkuar që:

APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit F.A nga Podujeva, Rruga "H." pn., dhe detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nga Fushë Kosova, Zona Industriale, për kompensimin e dëmit material të shkaktuar në fermën e paditësit nga përgjegjësia objektive e të paditurës, në shumën e përgjithshme prej 134,600.00 euro, dhe kjo:

Shuma prej 38,00.00 euro, në emër të dëmit të pësuar për dhitë e ngordhura,

Shuma prej 38.800 euro, në emër të fitimit të humbur në keca,

Shuma prej 18,000.00 euro, në emër të fitimit të humbur në qumësht,

Shuma prej 6,000.00 euro, në emër të bazës materiale e siguruara paraprakisht për nevoja të fermës (sanë, krune dhe drithë),

Shuma prej 23.800.00€euro, në emër të degradimit të ndërtesës së fermës dhe

Shuma prej 10,800.00 euro në emër të degradimit të ndërtesës për banim të punëtorëve, të gjitha këto me kamatë ligjore si në mjetet e deponuara në bankë, pa destinim të caktuar, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë."

OBLIGOHET paditësi F.A nga Podujeva, Rruga "H." pn., që të bëjë pagesën e shpenzimeve për ekspertizën e veterinarisë në shumën prej 150 €, në llogarinë e ekspertit të veterinarisë Agim Rexhepi, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Secili pjesëmarrës në procedurë i bartë shpenzimet e veta procedurale."

Kundër këtij Aktgjykimi, ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditësit është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datë 15.10.2011, ka ushtruar padi ndaj të paditurës për kompensim dëmi për shkak të falimentimit të biznesit si pasojë e sëmundjes së brucelozës, duke kërkuar, nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet e paditura që në emër të dëmit material, paditësit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134,600.00 euro. Ka shtuar se bazuar në shkresat e lëndës dhe provat materiale bashkangjitur padisë kuptojmë që e paditura nuk ka kryer me përgjegjësi dhe në mënyrë profesionale detyrimet ligjore, kjo për faktin se në

rastin konkret nuk janë ndërmarr veprime konkrete për parandalimin e sëmundjes me ç'rast ka ardhur deri te ngordhja e dhive dhe edhave e për pasojë paditësit i shkaktohet dëm i konsiderueshëm material dhe jo material, deri në falimentimin e biznesi të tij familjarë.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 05.10.2021, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.329/2011, i datës 05.10.2021, me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të këtij aktgjykimi gjykata ka theksuar se, pas vlerësimit me kujdes dhe ndërgjegje të të gjitha provave veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Gjykata ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe për të vërtetuar shkakun e infektimit, diagnozën e ngordhjes, ka bërë nxjerrjen e provës me Ekspertizë të veterinarisë, nga eksperti Dr. i Veterinës H.A, i cili në sqarimet e dhëna në pyetjet e palëve ndërgjyqëse në seancën gjyqësore ka ardhur në përfundimin se: dhitë edhe mund të kenë qenë të infektuara me sëmundjen e brucelozës (brucelozë është sëmundje shumë e shpeshtë në kafshët e imëta e sidomos në vendet në tranzicion, të cilat nuk kanë arritur përmes planeve kombëtare ta çrrënjosin me anë të masave parandaluese), por dhitë nuk mund të kenë ngordhur si pasojë e infektimit me sëmundjen e brucelozës, pasi që kjo sëmundje në përgjithësi nuk shkakton ngordhje, - dhitë e ngordhura janë diagnostifikuar me sëmundjen e Listeriozës, dhe - për sëmundjen e Listeriozës nuk bëhet kompensimi nga ana e shtetit, pra nuk përfshihet në listën e sëmundjeve kompensuese siç janë: sëmundjet infektive zoonotike me karakter tepër përhapës që rrezikojnë ekonominë dhe shëndetin publik.

Me tutje ka theksuar se, nga ekspertiza tjetër e ekspertit Dr. Agim Rexhepi, Patologji Veterinare, i cili në ekspertizën e tij bazuar në dokumentacionin në dispozicion, analizave laboratorike, përvojën e tij në lëmin e mjekësisë veterinare dhe hulumtimit, ka ardhur në përfundim se: shfaqja e sëmundjes së listeriozës, nuk përjashton mundësinë e pranisë njëkohësisht edhe të infeksionit me brucelozë. Mirëpo, në dokumentet në shkresat e lëndës nuk janë raportuar shenja klinike dhe analiza laboratorike për brucelozën. Kështu edhe nuk mund të konstatohet se dhitë kanë qenë të infektuara me brucelozë. Dhitë kanë ngordhur si pasojë e infeksionit me Listeria. Të cilit mendim të dy ekspertëve, gjykata iu dha besimin e plotë dhe i miratoi në tërësi ekspertizat e kryera, meqë të njëjtat ishin të mbështetura dhe argumentuara me prova e të cilat kanë elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale e shkencore për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore.

Me nenin 154 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), është përcaktuar se: *“Kush i shkakton dëmin tjetrit ka për detyrë ta kompensoi, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”*

Andaj, sa i përket bazës juridike të vërtetuar si më lart, në këtë rast mungon dhe nuk ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit material të shkakuar në fermën e paditësit, sepse pala paditëse nuk arriti që me prova ta vërtetoi se e paditura ka përgjegjësinë për

kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e ngordhjes së dhive në fermën e tij, meqë u vërtetua me prova se dëmi i shkaktuar paditësit si pasojë e ngordhjes së dhive në fermën e tij nuk është shkaktuar si pasojë e sëmundjes së Brucelozës, respektivisht dëmi nuk është shkaktuar me fajin e të paditurës.

Prandaj, pretendimet e paditësit për gjykatën janë të pabazuara, të paargumentuara me prova dhe pa mbështetje ligjore e që në kuptim të kësaj rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, pasi që në dispozitat e nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006, është përcaktuar se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*, kurse me dispozitën e nenit 319.1 të LPK-së, përcaktohet se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta., respektivisht Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit.”*, por paditësi nuk e bëri këtë dhe nuk mundi të bëjë të bazuar dhe të besuar me argumente dhe prova konkrete kërkesën e tij në mënyrë që të aprovohet nga gjykata.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret është vërtetuar se dëmi është shkaktuar me fajin dhe në kufijtë e përgjegjësisë së paditësit nga sendi nën zotërimin e tij, i njëjti nuk mund të kërkojë nga e paditura që të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar me fajin e tij dhe brenda kufijve të përgjegjësisë së tij.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449, 450, 451 dhe 453 të LPK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit, duke vlerësuar afatëshmërinë e ankesës, vërtetoi se, paditësi respektivisht i autorizuari i tij aktgjykimin e ankimuar e ka pranuar me datë 11.10.2021, fakt i cili vërtetohet nga fletëkthesa, e cila gjendet në shkresat e lëndës. Bazuar në udhëzimin juridik në aktgjykimin e atakuar, afati për ankesë është përcaktuar 15 ditë. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës ishte data 26.10.2021, ndërsa paditësi, ankesën kundër këtij aktgjykimi nëpërmjet postës rekomande R-1978404 e ka paraqitur me datë 15.11.2021.

Gjykata e Apelit vlerëson se, aktgjykimi i atakuar në mënyrë të rregullte i është dorëzuar të autorizuarit të tij, ndërsa paditësi kundër aktgjykimit të shkallës së parë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit më datë 15.11.2021, e verifikuar kjo nga vula e Postës në Podujevë në zarin me të cilin është dërguar ankesa për paditësin. Sipas kësaj, rezulton se, dita e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 26.10.2021, që ka qenë ditë e Marte dhe ditë pune, ndërsa siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe vula e pranimit në postë, e njëjta është dorëzuar me datë 15.11.2021, pra, pas skadimit të afatit ligjor.

Nisur nga kjo gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se ankesa e të paditurës është e vonuar (e pa afateshme) dhe si e tillë është hedhur, me arsyetimin se ankesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor i cili është paraparë me dispozitat e nenit 176 par.1 të LPK-së, të cilin afat e përmban edhe udhëzimi për përdorimin e mjetit juridik në kopjen e aktgjykimit të gjykatës së

shkallës së parë. Prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se, ankesa është dorëzuar pasa afatit të përcaktuar ligjor dhe si e tillë është e pasafateshme.

Me dispozitën e nenit 186 paragrafi 1 të LPK-së, parashihet që: *“Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore.”* ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*, ndërsa me dispozitën e nenit 196 përcaktohet se : *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të jo të lejueshme e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së”*, andaj në kuptim të dispozitave të cituara, e duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, gjykata ankimore ka gjetur se ankesa e paraqitur nga ana e të paditësit duhet të hedhet poshtë si e pasafatshme, prandaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 196 lidhur me nenin 186 par.1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9913/2021, me datë 16.01.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.